



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1204/9 prot

Datë 18.07.2022

V E N D I M
Nr. 676/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-27372-05-04-2022, me objekt “*Hartim projekti rehabilitim rrugës “A.Goga-Spitali”*”, me fond limit 4,166,660 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Studio Services K-SA SHPK
Lagjia 3, Rruga Egnatia, Pallati 1125, Kati 1, Durrës

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Iliria”, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.05.2022, është publikuar në SPE procedura e prokurimit “Shërbim Konsulencë”, me Nr. REF-27372-05-04-2022, me objekt “Hartim projekti rehabilitim rrugës “A.Goga-Spitali”, me fond limit, 4,166,660 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar zhvilluar në datë 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 20.05.2022, referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

II.3. Në datën 06.06.2022, Autoriteti Kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për

përzgjedhjen e kandidatëve për fazën e parë – shprehje interesit dhe parakualifikimi në mënyrë elektronike ku rezulton se operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK, është i skualifikuar si më poshtë:

- NET- Group	I kualifikuar
- TOWER	I kualifikuar
- TAULANT SHPK	I kualifikuar
- INFRATECH	I kualifikuar
- Instituti Dekliada - ALB	I kualifikuar
- C.E.C Group	I skualifikuar
- Enginnering Consulting Group	I skualifikuar
- Dricons	I skualifikuar
- Grama	I skualifikuar
- SPHAERA	I skualifikuar
- Seed Consulting	I skualifikuar
- Mag Partners	I skualifikuar
- Novatech Studio	I skualifikuar
- Atria Studio	I skualifikuar
- STUDIO SERVICES "K - SA"	I skualifikuar

II.4. Në datën 07.06.2022 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1204/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2259 e operatorit ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulencë*”, me Nr. REF-27372-05-04-2022, me objekt “*Hartim projekti rehabilitim rrugës “A.Goga-Spitali”*”, me fond limit 4,166,660 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.5. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomikë ankimues “Studio Services K-SA” SHPK.

II. 7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1204/3 prot., datë 20.06.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon autoritetit kontraktor shkresën me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK.

II.8. Njëpërmjet shkresës nr. 6006 prot., datë 06.07.2022, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1204/6 prot., datë 08.07.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me lëndë “Dërgim vendimesh” njëpërmjet të cilës na bën me dije se nuk është i mundur verifikimi i pretendimeve të operatorit ekonomik lidhur me skualifikimin e tij për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, Faza 1- Shprehja e interesit dhe parakualifikimi në mënyrë elektronike me objekt: “Hartim projekti rehabilitimi rrugës A.Goga-Spitali”. Në sistemin elektronik të APP, tek skedari “Hetim” nuk bëhet e mundur shfaqja e dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë. Në këto kushte Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendim të njëpërmjetëm vendosi: Të ndërpresë shqyrtimin e ankesës deri më datën 13 korrik 2022 në zbatim të nenit 100 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

II.9. Njëpërmjet postës elektronike në datë 13.07.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit publik vendimi i autoritetit kontraktor protokolluar me nr.1204/7 prot., datë 13.07.2022 lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit në të cilën është vendosur pranimi i ankesës së bërë nga operatori ekonomik ankimues.

Konkretisht autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka argumentuar si më poshtë:

“[...]Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se “Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1’600’000 lekë”, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri janë paraqitur shërbime jo të ngjashme me objektin e prokurimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit që ka të bëjë me dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1,600,00 lekë konstatohet se:

Operatori ekonomik Studio Services K-sa ka paraqitur si punë të ngjashme:

- 1. Hartimi i projektit – asfaltim i rrugës nga porta 2 tek terminali i trageteve”, me vlerë totale të kontratës 492 154.18 lekë me tvsh.*
- 2. Plane rilevimi për objektet e UKD, me vlerë totale të kontratës 936.000 lekë me tvsh.*
- 3. Studim – projektim, përmirsimi i sistemit të mbrojtjes ndaj zjarrit në godinën qendrore currila Durrës dhe Godinën Nr.1 të kampusit Universitar dhe realizimi i shkallës së emergjencës në godinën currila”, me vlerë totale 221.859.52 me tvsh.*
- 4. Studimi dhe hartimi i projektit të zbatimit për objektin “Ndërtim i ujësjellësit për furnizimin me ujë të zonës Levan-Seman”, me vlerë totale të kontratës 3.424.800 me tvsh.*
- 5. Projekt preventiv për ujësjellësin në zonën DMA 6 dhe ujësjellësi Afrim i ri shkolla Bujqësore, me vlerë totale të kontratës 934.253.6 me tvsh.*
- 6. Projekt për veprën inxhinierike furnizimit me ujë, projektit të KUB, projektit të KUZ dhe Rilevimi topografik, me vlerë totale të kontratës 1.218.000 lekë me tvsh.*

7. Projekt konstruktiv dhe projekt inxhinierik, me vlerë totale të kontratës 845.481.6 me tvsh .

Konsiderojmë si punë të ngjashme:

1. Hartimi i projektit – asfaltim i rrugës nga porta 2 tek terminali i trageteve, me vlerë totale të kontratës 492 154.18 (katërqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë me TVSH.
2. Projekt për veprën inxhinierike furnizimit me ujë, projektit të KUB, projektit të KUZ dhe Rilevimi topografik, me vlerë totale të kontratës 1.218.000 (një milion e shtatëqind e dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë me tvsh.

Vlera totale e punëve të ngjashme është 1710154.18 (një milion e shtatëqind e dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë me tvsh.

Vlera e sipërcituar është më e madhe se vlera e kërkuar në DST tek kërkesat e veçanta, kapaciteti teknik (1600000 lekë), prandaj në gjykimin tonë ankesa e operatorit ekonomik STUDIO SERVICES “K-SA” pranohet.[...].

II.10. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen: “[...]Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit, pra punë të ngjashme jo vetëm rikonstruksion rrugësh sepse autoriteti kontraktor ka kërkuar:

Kategoria 2.d – projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Kategoria 4.1 – Projektim i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.

Kategoria 5. C – ujësjellës kanalizime urbane – rurale

Kategoria 6. A- rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Kategoria 8. A rilevime inxhinierike, d) bazamente gjeodezike.

Kategoria 11. A sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore. Pra ka kërkuar rievime inxhinierike OE ka futur si punë të ngjashme Ujësjiellës, KUZ dhe KUB, ka kërkuar rrugë OE ka futur rikonstruksion rrugës, ka kërkuar sinjalistikë OE ka futur sinjalistik. Pra në zbatim të ligjit OE ka provuar me punë të ngjashme të ndryshme që është e aftë të japë konsulencën e tij jo vetëm me licencat që disponon por edhe me gamën e gjërë të projekteve të realizuara. Por edhe sikur ky arsytim mos të qëndrojë AK nuk mund të skualifikojë një OE përderisa OE ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit që i plotëson këto. Vetëm në fazën e dytë të procedurës së prokurimit mund të shihen disponimi i dokumentacionit nga OE dhe i kërkuar nga AK. A ka ngarkuar AK preventiv lidhur me zërat dhe vlerën e kategorive të kërkuar? Për derisa nuk ka kërkuar atëherë OE është i lirë të paraqesi vetëm 1.600.00 lekë rievime inxhinierike ose ujësjiellësa si punë të ngjashme. Ak mund të vlerësojë OE lidhur me eksperiencën në fushën përkatëse me sasin e pikëve të përcaktuar për këtë kriter. Në këto kushte kërkojmë prishjen e KVO dhe kualifikimin e OE për në fazën e dytë të procedurës së mësipërme[...] .

III.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1204/3 prot., datë 20.06.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon autoritetit kontraktor shkresën me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Studio Services K-SA”SHPK.

III.3. Nëpërmjet shkresës nr. 6006 prot., datë 06.07.2022, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1204/6 prot., datë 08.07.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me lëndë “Dërgim vendimesh” nëpërmjet të cilës na bën me dije se nuk është i mundur verifikimi i pretendimeve të operatorit ekonomik lidhur me skualifikimin e tij për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, Faza 1- Shprehja e interesit dhe parakualifikimi në mënyrë elektronike me objekt: “Hartim projekti rehabilitimi rrugës A.Goga-Spitali”. Në sistemin elektronik të APP, tek skedari “Hetim” nuk bëhet e mundur shfaqja e dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë. Në këto kushte Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendim të ndërmjetëm vendosi: Të ndërpresë shqyrtimin e ankesës deri më datën 13 korrik 2022 në zbatim të nenit 100 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.4. Nëpërmjet postës elektronike në datë 13.07.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit publik vendimi i autoritetit kontraktor protokolluar me nr.1204/7 prot., datë 13.07.2022 lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit në të cilën është vendosur pranimi i ankesës së bërë nga operatori ekonomik ankimues.

Konkretisht autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka argumentuar si më poshtë:

“[...]Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se “Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo

më të vogël se 1'600'000 lekë”, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se në permbushje të këtij kriteri janë paraqitur shërbime jo të ngjashme me objektin e prokurimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit që ka të bëjë me dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1,600,00 lekë konstatohet se:

Operatori ekonomik Studio Services K-sa ka paraqitur si punë të ngjashme:

1. Hartimi i projektit – asfaltim i rrugës nga porta 2 tek terminali i trageteve”, me vlerë totale të kontratës 492 154.18 lekë me tvsh.
2. Plane rilevimi për objektet e UKD, me vlerë totale të kontratës 936.000 lekë me tvsh.
3. Studim – projektim, përmirsimi i sistemit të mbrojtjes ndaj zjarrit në godinën qendrore currila Durrës dhe Godinën Nr.1 të kampusit Universitar dhe realizimi i shkallës së emergjencës në godinën currila”, me vlerë totale 221.859.52 me tvsh.
4. Studimi dhe hartimi i projektit të zbatimit për objektin “Ndërtim i ujësjellësit për furnizimin me ujë të zonës Levan-Seman”, me vlerë totale të kontratës 3.424.800 me tvsh.
5. Projekt preventiv për ujësjellësin në zonën DMA 6 dhe ujësjellësi Afrim i ri shkolla Bujqësore, me vlerë totale të kontratës 934.253.6 me tvsh.
6. Projekt për veprën inxhinierike furnizimit me ujë, projektit të KUB, projektit të KUZ dhe Rilevimi topografik, me vlerë totale të kontratës 1.218.000 lekë me tvsh.
7. Projekt konstruktiv dhe projekt inxhinierik, me vlerë totale të kontratës 845.481.6 me tvsh .

Konsiderojmë si punë të ngjashme:

1. Hartimi i projektit – asfaltim i rrugës nga porta 2 tek terminali i trageteve, me vlerë totale të kontratës 492 154.18 (katërqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë me TVSH.
2. Projekt për veprën inxhinierike furnizimit me ujë, projektit të KUB, projektit të KUZ dhe Rilevimi topografik, me vlerë totale të kontratës 1.218.000 (njëmilion e shtatëqind e dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë me tvsh.

Vlera totale e punëve të ngjashme është 1710154.18 (njëmilion e shtatëqind e dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë me tvsh.

Vlera e sipërcituar është më e madhe se vlera e kërkuar në DST tek kërkesat e veçanta, kapaciteti teknik (1600000 lekë), prandaj në gjykimin tonë ankesa e operatorit ekonomik STUDIO SERVICES “K-SA” pranohet.[...].

III.5. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të

ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.5.1. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-27372-05-04-2022, me objekt “*Hartim projekti rehabilitim rrugës “A.Goga-Spitali”*”, me fond limit 4,166,660 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 06.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro